

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AV Consulting” sh.p.k

Kreu I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

FORMIMI I SHOQËRISË

Neni 1

a. Sot në Tirane në datën 10 Janar 2024 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “**AV Consulting**” sh.p.k, me vullnetin e lirë të ortakut te vetem, në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, I ndryshuar, formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “**AV Consulting**” sh.p.k, nga ortaku themelues:

1. **Anila Jaupaj**, shtetase shqipte, e bija e Gezimit dhe I Katerines, i datëlindjes 02/10/1991 me te drejta te plota për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr .karte identitet J16002092T me adresë Rr Bogdaneve, Nd 14, H4 10 Ap 7 Njesia nr 10 Tirane
- b. I cili me vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe Aktin e Themelimit, ka vendosur të destinoje në këtë sipërmarrje kapitalin e saj, me qëllim që të përfitoje të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private e shoqërisë, si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.
- c. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë. Shoqëria tregtare “ **AV Consulting** ” sh.p.k., fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit të saj pranë zyrës së Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË


Neni 2

1. Shoqëria tregtare, është e organizuar si **Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar**.
2. Emërtimi i Shoqërisë është: “ **AV Consulting** ” sh.p.k.
3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare, mund të ruhet i njëjtë emërtim, me kusht që Personi Juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 3

1. Shoqëria tregtare “ **AV Consulting** ” sh.p.k., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në Qarkun e Tiranes, me adresë Rr Bogdaneve Villa 22, Kat 2 Dera 1, Njesia Bshkiakë nr 10 Tirane Shoqëri mund të krijojë qendra dytesore, filiale, zyra përfaqesimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.
3. Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
4. Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në perputhje me legjislacionin Shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë saj në përputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendrën e tij.



5. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

KOHËZGJATJA

Neni 4

1. Shoqëria Tregtare " AV Consulting" sh.p.k., do të përbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
- 2.Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 5

Objekti i shoqerise " AV Consulting" sh.p.k do të jetë:

1 . Kurse kontabiliteti, Trajnimet te programeve financiare

TË DREJTAT E SHOQËRISË

Neni 6

Shoqeria tregtare " AV Consulting" sh.p.k., nuk pergjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale qe ortaku zhvillon në menyre të pavarur prej saj.
Shoqeria mund të ndryshoje emrin , seline, kohezgjatjen, objektin e veprimtarise, administratorin , sipas vendimeve qe do të marri ortaku i vetem .

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 10 000 lekë (dhjete mijë leke), i cili është tërësisht kapital finanziar . Kapitali themeltar është i ndarë në 1 kuote të së njëjtës kategori me vlerë nominale 10 000 lekë (dhjete mijë)leke ,pjesët janë të numërtuara nga njëshi deri tek njëqinda duke përfshirë dhe numrin e fundit të pjesëve.

Kapitali themeltar zotërohet nga:

1. Anila Jaupaj , zotërues i 100 %(qindperqind) te kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Ortaku i vetem ka të drejtë të tjetërsoje, të zmadhoje apo të pakësojë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji.Kapitali fillestar nuk është paguar.

NENI 8

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde të tjera të veçanta të financimit per zhvillimin ekonomik e tregtar.

NENI 9

1. Perberja e kapitalit të shoqerise, fondet e krijimit të saj si dhe perdonimi e rregullimi i çdo fondi të veçante percaktohen nga Ortaku sipas të drejtave dhe detyrave të percaktuara në statut.


2. Të ardhurat e per gjitheshme të shoqerise dhe në per gjithesi çdo operacion finanziar i saj do të pasqyrohet në kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit në fuqi dhe në mbeshtetje të akteve perkatese të rrjedhura prej tij.

NENI 10

1. Shoqeria Tregetare " AV Consulting" sh.p.k., eshte pronare e pasurise së saj të cilën e perdor dhe e disponon në emer të saj në perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise së shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lirë të bleje dhe të shfrytezoje të drejta të tjera materiale në perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.
3. Të gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike e juridike paguhën nga fondet e shoqerise.

NENI 11

1.Pasurite e shoqerise vleresohej në monedhe shqiptare.



2. Aktiviteti finanziar i shoqerise do të mbyllt me 31 Dhjetor të çdo viti dhe pasqyrat financiare do të hartohen e miratohen brenda tre muajve të vitit në vazhdim.

3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit finanziar, raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe specialistet dhe nëse e kërkon ligji nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me Vendim të Ortakut të vetem saj.

NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar Jane lirisht të transferueshme në rruge trashegimie. Ato Jane lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

NENI 13

Transferimi i pjesave të kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfittues do të behet pasi ata të pranojnë përbajtjen e statutit të kesaj shoqerie tregtare me gjithë ndryshimet qe ai mund të kete pesuar deri në momentin qe keto pjesa të kapitalit themeltar behen të transferueshme.

NENI 14

Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të trete qe nuk bejne pjesë në shoqeri vetem me miratimin e Ortakut.

NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anen e kontributeve në para dhe në natyre apo / zvogelimi i tij behet me Vendimin e Ortakutte vetem të shoqerise mbi bazen e një projekti të paraqitur nga ekonomisti i firmës ose kontabli i miratuar.

KREU I DYTË

ORTAKËRIA

NENI 16

Ortaku i vetem i shoqërisë tregtare " AV Consulting" sh.p.k., gëzon të gjitha të drejtat dhe merr përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqiperise, në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqerise.

Te drejtat dhe detyrat e Ortakut

NENI 17

1. Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve duke ushtruar të drejtën e votës së tij;
2. Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit;
3. Të informohet mbi përbajtjen e raportit të administrimit, inventaret e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabël;
4. Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
5. Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

KREU I TRETË

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 18

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, asambleja e ortakut emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik , të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administratori i emëruar i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë me përjashtim të rasteve të veçanta që ligji i jep shprehimisht ortakut të shoqërisë.
2. Shoqëria do të administrohet nga administratori **Anila Jaupaj**, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjecare dhe me të drejtë rizgjedhje.
3. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
4. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjetër, i cili emërohet me Vendim të Ortakut te vetem.

ASAMBLEJA

NENI 19

1. Asambleja e Ortakut është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Ortaku mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

NENI 20

Asambleja e Ortakut ka të drejtë :

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut;
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë
3. Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
4. Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë;
5. Të shpallë prishjen, likujdimin dhe falimentimin e shoqërisë;
6. Të shprehet për kohëzgjatjen e shoqërisë;
7. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
8. Të miratojë strukturat e shoqërisë etj.;
9. Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqërisë dhe Statuti i saj.
10. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

TË DREJTAT E ADMINISTRATORIT

NENI 21

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët, e me administratën publike ;
2. Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm ose drejtuesin teknik që i nevojitet asaj në përbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakut strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe të përbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punës Republikës së Shqipërisë;
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuara nga Asambleja e Ortakut;
5. Të testojë aftësitë e punonjësve në administratë;
6. Të thërrasë Asamblene e Ortakut dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar;
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortaku i vetem;
8. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratim nga Asambleja e Ortakut i vetem.

NENI 22

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 23

1. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekonomist të licensuar dhe kur kërkohet nga ligji me një ekspert kontabël të autorizuar, të cilët janë përgjegjës për problemet që mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tyre.
2. Për emërimin, kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, têrheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar në fuqi.

NENI 24

1. Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në perputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.
2. Marrja në punë bëhet me regjistrimin nga punëdhënësi në Librin e Punës së Shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet e Punës së Juridiksionit ku ushtron aktivitetin Shoqëria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimitarës së Shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi nuk është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës të Rrethit Gjyqësor.

FORCAT MADHORE

NENI 25

Ortaku nuk mban përgjegjësi kur ka paaftesi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasojë e rrëthanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënshkrimit të kontratës dhe ortaku nuk mund ti shmanget me masa të arsyeshme.

Ngjarje të forcave madhore janë ato që i shpëtojnë kontrollit të ortakut.

Kur ortaku ndodhet në paaftesi të plotësujë detyrimet e tij për arsyet e forcave madhore, në bazë të kontratës dhe statutit duhet të bëje cdo përpjekje që ta kapërceje këtë vështirësi.

SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

NENI 26

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në cdo kohë dhe për çfarëdo shkaku. Shoqëria mund të prishet para kohe;

-Me vendim të ortakut.

-Kur mbaron kohëzgjatja e shoqërisë.

-Pas dy vjetëve të veprimitarës me bilanc negativ(Humbje).

-Me vendim të gjykatës ose për arsyet e tjera të parashikuara në statut.

Në rast mbyllje ortaku vendosë mbi mënyrat e likuidimit dhe caktonë një ose më shume likujdatorë duke ju përcaktuar dhe detyrat. Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënim ” Shoqëri në likuidim ”.

Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likuidimit dhe kryen formalitetet e duhura, shoqëria çregjistrohet nga regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

BAZA LIGJORE

Neni 27

E gjithë veprimitaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, I ndryshuar si dhe në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 28

Ortaku detyrohet që të mos nxjerr tek të tretët të dhëna dhe njoftime secrete që kanë të bëjnë me veprimitarinë ekonomike të shoqërisë.

Ortaku i shoqërisë përcaktonë llojin e të dhënave dhe informatave që konsiderohen sekrete.

DISPOZITA TË FUNDIT
NENI 29

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", I ndryshuar si dhe Legjislacioni Shqiptar në fuqi.

NENI 30


Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqerisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

NENI 31

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqerisë.

ORTAKU I VETEM

Anila Jaupaj

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Anila Jaupaj". The signature is fluid and cursive, with the name "Anila" on the left and "Jaupaj" on the right, separated by a vertical line.